



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Makroekonomia 2 EKB0021

Bartësi i lëndës:	Alban Zogaj
Email:	alban.zogaj@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322
Mësimdhënësit e Lëndës:	Fisnik Bajrami

Hyrje

Makroekonomia II jep një pasqyrë me te avancuar të koncepteve të funksionimit të ekonomisë në nivel nacional. Në kete lende trajtohen tema të veqanta mbi llogarite kombetare, teorite moderne të rritjes, për të kaluar më pas në qasjen kater-sektoriale të makroekonomisë duke trajtuar problematikën e prodhimit dhe kerkeses agregate, inflacionit dhe normave të kembimit, papunësisë, rritjes ekonomike, analiza, parashikimi dhe politikat në sektorin financiar, sektorin e jashtëm dhe fiskal. Pasi të krijohet një pasqyrë për sektoret e ekonomisë kalohet në analizën e ndërhyrjes së shtetit dhe instrumentet që përdoren në kuadër të politikës monetare, fiskale, reformat dhe politikat strukturore dhe roli i institucioneve për t'i arritur objektivat makroekonomike. Poashtu do të shtjellohen tema nga tregtia ndërkombëtare dhe levizja e kapitalit në kushtet e globalizimit. Cdo teme do të shtjellohet përmes shembujve praktik me theks të posaqem për ekonomine e Kosoves.

Qëllimet

Kjo lende ka për qëllim tu ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet kryesore të funksionimit të ekonomisë nacionale dhe politikave ekonomike. Lenda ka po ashtu për qëllim rritjen e aftësive të studentëve për të kuptuar dhe analizuar në mënyrë kritike çështjet që lidhen me ekonomine reale, sektorin financiar, fiskal dhe të jashtëm, si dhe nderlidhjen e tyre në kontekstin makroekonomik. Studentët do të mund të formojnë opinionin e tyre në lidhje me situatën makroekonomike duke përdorur treguesit makroekonomik të shpjeguar gjatë këtij kursi, Të vlerësojnë efektin e politikave fiskale, monetare dhe strukturore në lëvizjet e agregateve kryesore makroekonomike në kontekst të situatave të caktuara, Të bëjnë nderlidhjen ndërmjet sektoreve të ekonomisë, Te prezantojnë në forme tabelore, grafike, dhe në modele të thjeshta matematikore problemet makroekonomike, si dhe të formulojnë mendimet e tyre nëpërmjet eseve për tema të caktuara.

Rezultatet e pritura të lëndës

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që: 1. Të formojnë opinionin e tyre në lidhje me situatën makroekonomike duke përdorur treguesit makroekonomik të shpjeguar gjatë këtij kursi, 2. Të vlerësojnë efektin e politikave fiskale, monetare dhe strukturore në lëvizjet e agregateve kryesore makroekonomike në kontekst të situatave të caktuara, 3. Të bëjnë nderlidhjen ndërmjet sektoreve të ekonomisë, 4. Te prezantojnë në forme tabelore, grafike, dhe në modele të thjeshta matematikore problemet makroekonomike, si dhe të formulojnë mendimet e tyre nëpërmjet eseve

- per tema te caktuara.

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Hyrje ne Makroekonomia II	Ligjerate
2	Kontabiliteti i Te Ardhurave Kombëtare	Ligjerate dhe Ushtrime
3	Te Ardhurat dhe Shpenzimet	Ligjerate dhe Ushtrime
4	Paraja, Interesi dhe Te Ardhurat	Ligjerate dhe Ushtrime
5	Politika Monetare dhe Fiskale	Ligjerate dhe Ushtrime
6	Kërkesa dhe Oferta Agregate	Ligjerate dhe Ushtrime
7	Oferta Agregate: Pagat, Çmimet dhe Punëzënia	Ligjerate dhe Ushtrime
8	Rritja Ekonomike Afatgjate dhe Produktiviteti	Ligjerate dhe Ushtrime
9	Konsumi dhe Kursimi	Ligjerate dhe Ushtrime
10	Shpenzimet për Investime	Ligjerate dhe Ushtrime
11	Kërkesa për Para	Ligjerate dhe Ushtrime
12	Dinamikat e Inflacionit dhe Papunësisë	Ligjerate dhe Ushtrime
13	Deficitet e Buxhetit dhe Borxhi Publik	Ligjerate dhe Ushtrime
14	Problemet makroekonomike ne Kosove	Ligjerate dhe Ushtrime

Informata shesë 1:

Lenda nderlidhe pjesen teorike me ate praktike permes ushtrimeve te shumta kompjuterike, permes vizitave tek Agjensionet Makroekonomike te vendit, dhe permes ligjeruesve musafire te cilet ndajne pervojat e tyre me studentet.

Informata shesë 2:

1. Kompjuteri dhe projektori, 2. Programet kompjuterike per modelim makroekonomik.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Kolokvium	45	Po	Test me shkrim
2	Kolokvium	45	Po	Test me shkrim
3	Pjesëmarrja	10		pjesemarrje aktive ne detyra dhe diskutime

Kushtet e përsëritjes:

Nëse studentët nuk i nënshtrihen provimit të lëndës në afatin e dhënë, atëherë llogaritet se kanë shpenzuar afatin dhe mundësinë brenda vitit akademik. Nëse pas 3 mundësive për nënshtrim të provimit brenda një viti akademik, studentët nuk kalojnë lëndën, atëherë ata obligohen të e përsërisin sërish lëndën në vitin vijues akademik. Nëse studentët nuk arrijnë që ta kalojnë lëndën në mundësinë e parë në fund të ligjëratave, atëherë vlerësimet e mëhershme (detyrat, vlerësimet e kollokviumeve) gjatë ligjëratave ju ruhen deri në afatin e tretë pra afatin shtatorit.

Burimet:

- 1. Dornbusch and Fischer (2000), "Makroekonomia - botim nderkombetar", Tirane, Dituria. 2. Dornbusch and Fischer (1994), "Macroeconomics", McGraw-Hill.

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	45	
Ushtrime:	10	
L+U:	55	
Seminar/praktike.:	30	
Studim i vazhdushem:	90	
Pregaditja e Provimit:	20	
Pjesemarrja ne teste:	4	
Pjesemarrja ne provimin final:	2	
Me profesorin dhe asistentin:	8	
Total Ore:	209	
ECTS:	8	